

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË—Departamenti i Përgjithshëm gjyqtarja Elife Uka, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mervete Krasniqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit G.C.për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës PP.II.nr.6023/16, të datës 15.05.2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, me dt. 26.03.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

G.C.nga i ati N., i lindur me ..., në P., me vendbanim në rrugën "... N.", pa numër P., me nmer personal ..., me numër kontaktues ... shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse

Me date 14.10.2016, rrethe orës 12:05, në rrugën "I.K.", në P., me të arritur tek udhëkryqi të Xh. e Ll., i akuzuari G.C., nga pakujdesia, e në kundërshtim me nenin 64.1-2 dhe neni 126.1 të LSKRR-së, ka rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë në komunikacion rrugore në atë menyre qe me të arritur në udhëkryq me automjetin e tipit "BMV X5", ngjyre të zezë, me targa të regjistrimit ..., duke mos mbajtur distancën e sigurisë mes automjeteve në komunikacion me pjesën e perparme të anës së majte e godet në pjesën e pasme të anës së djatht, automjetin e të dëmtuarit N.V., të ripit "Chervolet Sprak", ngjyre e kuqe, me targa të regjistrimit ..., me crast ne baze te ekspertizez mjeko ligjire nga Dr. M.G. dhe D.H., dt.23.04.2017, lendime të lejta trupore, ka pësuar N.V., si dhe janë shkaktuar dëme materiale ne automjete.

Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së,

Andaj, duke u bazuar në nenin 3,50,51,52,53,54,73,74, nenit 381, par. 3, lidhur me par. 1, të KPRK, dhe nenit 356 par.1 të KPRK-së, e

### G J Y K O N

ME DENIM ME BURGE në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili do ta mbaj po që se i njëjti në afatin prej 1 (një) viti nuk do të kryej vepër tjetër penale.

OBLIGOHET i pandehuri që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 60.88 €, dhe në emër të paushalalit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afatin prej 15 ditëve, nga dita kur Aktgjykimi e merr formën e prerë.

I dëmtuarit N.V. për realizimin e dëmit të shkaktuar udhëzohen në kontest të rregulltë juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP.II.nr.6023/16, të datës 15.05.2017, e ka akuzuar të akuzuarin G.C. për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta denojë sipas ligjit.

I pandehuri G.C. në shqyrtimin kryesor në tërësi e ka pranuar fajësinë në kuptim të nenit 326, par. 1, të KPRK, për veprën penale për të cilën e ngarkon Prokuroria e Shtetit, dhe se gjykata ka vlerësuar se janë përmbushur kërkesat nga neni 248, par. 1, po të këtij kodi, përkatësisht vlerësoj se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe mbështetet në faktet dhe provat që mbështetin aktakuzën.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaron: e mbështes aktakuzën e ushtruar kundër të akuzuarit G.C. , ngase kjo është vërtetuar në këtë seancë edhe me pranimin nga ana e të pandehurit , gjithashtu mbështetet në provat materiale dhe personale të ligjshme dhe të pranueshme , andaj i propozojmë gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet , dhe pas vlerësimit të të gjitha rrethanave lehtësuese dhe rënduese ti shqiptoi një dënim sipas KPRK-së.

I akuzuari në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se me vjen keq rastin që më ka ndodhur i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të bie ndesh e ligin ,por i propozoj gjykatës se meqë jam student dhe nuk jam në marrëdhënie pune të më shqiptoi një dënim të kushtëzuar .

Gjatë matjes së dënimit gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform të nenit 73, të KPRK, ashtu që rrethana rënduese nuk gjeti, kurse si rrethanë lehtësuese ka marrë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në seancën fillestare, se kishte sjellje korrekte, ka shprehur pendim të thellë, si dhe premtim se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin ashtu që gjykata e ka gjykuar me dënim të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit rrezikshmërisë reale shoqërore të veprës penale, do të i shërbejë si preventivës individuale ashtu dhe gjenerale, do të parandalojë që në të ardhmen mos të kryejë vepra penale, do të bëjë rehabilitimin e tij si dhe do të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprës penale, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 42, e që mund të arrihet edhe pa ekzekutimi e tij konform nenin 50 të KPRK.

Mbi kërkesën pasurore juridike është vendosur në konform të nenit 463, par.2, të KPRK-së.

Mbi shpenzimet e procedurës penale, është vendosur në konform të nenit 450, të KPRK.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365, të KPRK-së, u vendos i në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 2275/2017 i dt.26.03.2018

Procesmbajtësja  
Mervete Krasniqi

Gj y q t a r j a  
Elife Uka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate.